



**SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE**  
**ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR**  
**SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO**

**Numri i dosjes:** KSC-CC-2019-05

**Vendosi:** **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**

Gjykatëse An Pauër-Ford, kryetare

Gjykatës Vidar Stensland

Gjykatës Roland Dekers

**Administratorja:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 25 janar 2019

**Në vëmendje të:** **Parashtruesit**

z. Mahir Hasani

**PUBLIKE**

---

**Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës së z. Mahir HASANI për masë të  
përkohshme**

---

## Hyrje

1. Kërkesa e z. Mahir Hasani ('Parashtruesi') për masë të përkohshme në bazë të rregullës 21 të Rregullores së Punës<sup>1</sup> ('Kërkesa') e përfshirë në Referim<sup>2</sup> duhet të refuzohet. Nuk është demonstruar *prima facie* pranueshmëria dhe nuk paraqitet kurrfarë rreziku për dëm të rëndë dhe të pandreqshëm.

## Historia procedurale

2. Më 20 dhjetor 2018, Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') i dërgoi parashtruesit: (i) një fletëthirrje për t'u paraqitur në Hagë më 11 shkurt 2019, për marrje në pyetje nga ZPS-ja ('Fletëthirrja'); dhe (ii) një urdhër për të paraqitur dokumente dhe të dhëna në ZPS në Hagë më 11 shkurt 2019 ('Urdhri'). Fletëthirrja dhe Urdhri iu dorëzuan Parashtruesit në të njëjtën ditë.

3. Më 15 janar 2019, Parashtruesi i paraqiti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese Referimin ku, ndër të tjera, kërkon masa të përkohshme për pezullimin e Urdhrit deri në marrjen e një vendimi për pranueshmërinë dhe themelësinë e Referimit. Si Referimi, ashtu edhe Kërkesa, lidhen vetëm me Urdhrin dhe jo me Fletëthirrjen.<sup>3</sup>

4. Në të njëjtën ditë, në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit, Kryetarja e Dhomave të Specializuara nxori vendim për caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur në lidhje me Referimin ('Paneli').<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Rregullorja e Punës e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, KSC-BD-03/Rev1/2017, 21 korrik 2017 ('Rregullorja e Punës').

<sup>2</sup> Peticion i z. Mahir Hasani për konstatim të cenimit të të drejtave themelore të tij nga Zyra e Prokurorit të Specializuar përmes lëshimit të urdhrit VIY689 të datës 20 dhjetor 2018 për të paraqitur dokumente dhe të dhëna dhe kërkesë për masë të përkohshme, KSC-CC-2019-05/F00001, dorëzuar më 15 janar 2019, me tri shtojca konfidenciale ('Referimi'). Përkthimi në anglishte i Referimit u shpërnda më 18 janar 2019 (KSC-CC-2019-05/F00001/eng).

<sup>3</sup> Referimi, KSC-CC-2019-05/F00001/eng, f. 5.

<sup>4</sup> Vendim për caktimin e gjykatësve në një panel të Gjykatës Kushtetuese, KSC-CC-2019-05/F00002, 15 janar 2019. Korrigjimi i këtij vendimi u parashtrua për protokollim më 21 janar 2018, KSC-CC-2019-05/F00002/COR. Termi 'Panel' i përdorur në këtë Përgjigje përfshin panelin e caktuar të Gjykatës

5. Më 18 janar 2019, Paneli e ftoi ZPS-në që, më 25 janar 2019 ose para kësaj date, të dorëzonte parashtrime në lidhje me Kërkesën.<sup>5</sup> Gjithashtu, në lidhje me procedurën që lidhet me Referimin, Paneli: (i) kërkoi ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës;<sup>6</sup> dhe (ii) caktoi anglishten dhe shqipen si gjuhë të punës.<sup>7</sup>

### Parashtrimet

6. Masat e përkohshme duhen miratuar vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe vetëm nëse përndryshe do të shkaktohej dëm i rëndë dhe i pandreqshëm.<sup>8</sup>

7. Para se të paraqesë një çështje në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Parashtruesi duhet të përdorë mjetet juridike që i mundëson korniza ligjore e Dhomave të Specializuara, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, parashtrimin e çështjes para një gjykatësi të vetëm. Kur nga shqyrtimi *prima facie* duket qartë se referimi është i parakohshëm dhe rrjedhimisht i papranueshëm, si në rastin në fjalë, masat e përkohshme nuk duhet të miratohen.<sup>9</sup> Ky kriter parandalon që një

---

Kushtetuese dhe njëkohësisht kryetaren e Panelit që i ushtron kompetencat e saj në bazë të rregullës 21 të Rregullores së Punës.

<sup>5</sup> Njoftim në lidhje me parashtrimin e përgjigjes, KSC-CC-2019-05/F00003, 18 janar 2019 ('Njoftimi').

<sup>6</sup> Kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës, KSC-CC-2019-05-F00004, 18 janar 2019, njoftuar më 21 janar 2019.

<sup>7</sup> Vendim mbi gjuhët e punës, KSC-CC-2019-05/F00005, 18 janar 2019, njoftuar më 21 janar 2019.

<sup>8</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ('Kushtetuta'), neni 116(2) ('Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë veprimin [...] e kontestuar [...] nëse konsideron që aplikimi i veprimit [...] të kontestuar mund të shkaktojë dëme të pariparueshme'); Rregullorja e Punës, Rregulla 21(1) (kërkon marrjen e një vendimi se individ i përballet me rrezik real të dëmit të rëndë në rast mosmiratimi të masave të përkohshme'). *Shih po ashtu*, në lidhje me rregullën 39 (Masa të Përkohshme) të Rregullores së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('GJEDNJ'), *Kasymakhunov v. Russia*, nr. 29604/12, 14 nëntor 2013, para. 181 ('[r]ëndësia thelbësore e masave të përkohshme theksohet më tej nga fakti që në parim, Gjykata i lëshon ato vetëm në raste me të vërtetë të jashtëzakonshme dhe mbi bazën e shqyrtimit rigoroz të të gjitha rrethanave përkatëse. Në shumicën e këtyre rasteve, parashtruesit përballen me kërcënim të vërtetë për jetën dhe shëndetin fizik, me rrezikun vijues real të dëmit të rëndë dhe të pakthyeshëm në shkelje të dispozitave kyçe të Konventës').

<sup>9</sup> *Shih po ashtu*, rregulla 55(4)(a) e Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ('Kolegji shqyrtues [...] duhet të konstatojë se: (a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin *prima facie* për meritat e kërkesës dhe, nëse ende nuk është marrë vendim në lidhje me pranueshmërinë e saj, rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës'); Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ('GJKK'), Rasti Nr. KI06/15, *Parashtruesi Sadik Abazi*, Aktvendim për Papranueshmëri, 26 gusht 2016, para. 47 ('parashtruesi nuk ka treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Prandaj, kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme do të refuzohet si e pabazuar'); GJKK, Rasti Nr. KI 17/13,

mjet i jashtëzakonshëm për shmangien e shkeljeve të mundshme dhe të rënda, të shndërrohet në mjet për zvarritjen e procedurave edhe kur referimi bazë është qartësisht i papranueshëm ose i pathemeltë.

8. Në këtë rast nuk ekziston asnjë rrezik për dëm të rëndë dhe të pandreqshëm. Në fakt, nuk është bërë dhe nuk do të bëhej asnjë shkelje e të drejtave të Parashtruesit edhe sikur Kërkesa të mos miratohej. Në kundërshtim me parashtrimet e Parashtruesit, ku gjuha e përdorur në Fletëthirrje qëllimisht përzihet me gjuhën e përdorur në Urdhër,<sup>10</sup> Parashtruesi nuk është dhe nuk do jetë i kërcënuar me masë ndëshkuese kundër tij. Duke shfrytëzuar këshillim juridik të pavarur, Parashtruesi ka mundësinë të marrë një vendim të lirë në lidhje me ushtrimin e së drejtës së tij për të mos inkriminuar vetveten. Në vijim, nëse është e nevojshme, çështja mund t'i parashtrohet një gjykatësi të procedurës paraprake apo një gjykatësi të vetëm për të marrë vendim mbi fushëveprimin e asaj të drejte. Nuk do të ndodhë asnjë detyrim në lidhje me Urdhrin, pa mbikëqyrje gjyqësore.

9. Në përputhje me urdhrin e Panelit,<sup>11</sup> në këtë përgjigje, ZPS-ja paraqet parashtrimet e veta vetëm në lidhje me kërkesën e Parashtruesit për masë të përkohshme (d.m.th. Kërkesa). Në rast se Referimi nuk hidhet poshtë si i papranueshëm *prima facie*, ZPS-ja me respekt kërkon mundësinë të paraqesë parashtrime të tjera mbi pranueshmërinë dhe themelësinë e tij.

I. Pranueshmëria nuk është demonstruar *prima facie*

10. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për çështje që i referohen në mënyrë ligjore nga palë të autorizuar.<sup>12</sup> Sipas nenit 49(3) të Ligjit dhe nenit 113(7) të Kushtetutës,

---

*Parashtruesi Bujar Bukoshi, Vendim për Kërkesën për Masë të Përkohshme, 14 mars 2013 (duke e refuzuar kërkesën për masë të përkohshme kur referimi ishte i parakohshëm); GJKK, Rasti Nr. KI 102/16, Parashtruesi Shefqet Berisha, Aktvendim për Papranueshmëri, 2 mars 2017, para. 46 (ku po ashtu refuzohet kërkesa për masë të përkohshme kur referimi ishte i parakohshëm).*

<sup>10</sup> Referim, KSC-CC-2019-05/F00001/eng, f.13, 19.

<sup>11</sup> Njoftim, KSC-CC-2019-05/F00003, para. 5.

<sup>12</sup> Kushtetuta, neni 113(1); Ligji, neni 49(2) dhe (3); Rregullorja e Punës, rregullat 4 dhe 20.

individët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm pasi të kenë përdorur të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Rregullorja e Punës e shtjellon më tej këtë kriter duke vënë dy parakushtet e mëposhtme për paraqitjen e referimeve prej individëve para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese:

- (i) janë përdorur të gjitha mjetet juridike të efektshme që parashikon ligji në lidhje me shkeljen e pretenduar; dhe
- (ii) kërkesa referuese dorëzohet brenda dy (2) muajsh nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar në lidhje me shkeljen e pretenduar.<sup>13</sup>

11. Në rastin në fjalë nuk është përmbushur asnjëri nga këto kritere.

12. Në kundërshtim me parashtrimet e Parashtruesit,<sup>14</sup> korniza ligjore e Dhomave të Specializuara ofron garanci mbrojtëse dhe mjete juridike të disponueshme dhe efektive pikërisht për ato lloj shkeljesh të pretenduara të të drejtave kushtetuese të të dyshuarve që parashtrohen në këtë Referim. Fakti që ende nuk ka jurisprudencë lidhur me zbatueshmërinë e kornizës ligjore, nuk e liron Parashtruesin nga detyrimi i kërkimit të mjeteve të disponueshme juridike.<sup>15</sup>

13. Në veçanti, neni 39(1) dhe (3) i Ligjit dhe rregulla 48(2) e Rregullores së DHSK-së<sup>16</sup> i mundësojnë cilësdo palë (ku përfshihet i dyshuari ose mbrojtësi i specializuar)<sup>17</sup> që të kërkojë urdhra sikurse mund ta lypë hetimi ose përgatitja dhe kryerja e procedurave gjyqësore. Këto dispozita u hartuan qartë për t'i mundësuar një gjykatësi të procedurës paraprake apo një gjykatësi të vetëm të caktuar në bazë të neneve 25(1)(f) dhe 33(2) të trajtojnë çështjet që dalin gjatë kryerjes së hetimit, duke përfshirë

<sup>13</sup> Rregullorja e Punës, rregulla 20(1).

<sup>14</sup> Referim, KSC-CC-2019-05/F00001/eng, f.10, 14-15.

<sup>15</sup> Shih, për shembull, , ECtHR, *Nagovitsyn and Nalgiyev v. Russia*, nr. 27451/09 dhe nr. 60650/09, 23 shtator 2010, para. 30; ECtHR, *Ciupercescu v. Romania*, nr. 35555/03, 15 qershor 2010, para. 169.

<sup>16</sup> Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev1/2017, 5 korrik 2017 ('Rregullorja e DHSK-së').

<sup>17</sup> Shih Rregullorja e DHSK-së, rregulla 2.

çështje që lidhen me të drejtat e të dyshuarve të thirrur nga ZPS-ja, si në rastin e Parashtruesit.

14. Efektiviteti i këtyre dispozitave fuqizohet edhe më tej prej detyrimit të përgjithshëm të Dhomave të Specializuara sipas nenit 3(2) të Ligjit për të gjykuar dhe funksionuar në përputhje me Kushtetutën dhe të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, siç e ka theksuar edhe më parë Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese.<sup>18</sup>

15. Parashtruesi nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të kërkuar mjete juridike në përputhje me këto dispozita. Nëse do ta bënte këtë, do të kishte mundësinë që argumentet e tij të dëgjoheshin dhe të shqyrtoheshin nga një gjykatës i procedurës paraprake ose një gjykatës i vetëm si pjesë e procedurës normale, çka përfshin, nëse është e përshtatshme, edhe kërkesën për shqyrtim në apel.<sup>19</sup> Për rrjedhojë, Parashtruesi nuk i ka përdorur të gjitha mjetet efektive juridike që i ofron ligji në lidhje me pretendimet e ngritura.

16. Lidhur me këtë, është e qartë se nuk është marrë vendim përfundimtar. Madje, siç theksohet më lart, Parashtruesi nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të kërkuar vendim të një gjykatësi të procedurës paraprake apo një gjykatësi të vetëm. Në kundërshtim me parashtrimet e Parashtruesit,<sup>20</sup> Urdhri në vetvete nuk mund të përbëjë “vendim përfundimtar” në kuptimin e rregullës 20(1)(b) të Rregullores së Punës, duke mbajtur parasysh: (i) ekzistencën dhe disponueshmërinë e mjeteve juridike për Parashtruesin,

---

<sup>18</sup> AKTVENDIM mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, KSC-CC-PR-2017-01/F00004, 26 prill 2017, para. 11 (“[p]ajtohet se në disa aspekte e vetmja mënyrë për të qartësuar pa mëdyshje nëse një rregull e Rregullores është në përputhje me Kushtetutën, do të ishte shqyrtimi i mënyrës së zbatimit të një dispozite konkrete në rrethana konkrete. Kryesisht, dhe duke mbajtur parasysh parimet udhëzuese parashtruar më poshtë, Gjykata mbështetet në faktin se gjatë interpretimit dhe zbatimit të Rregullores, do të mbajë parasysh nenin 3(2)(a) dhe (e) të Ligjit”). Shih gjithashtu para 110 dhe 123 (ku trajtohet konkretisht kapitulli 4 i Rregullores së Punës).

<sup>19</sup> Rregullorja e DHSK-së, rregulla 77.

<sup>20</sup> Referim, KSC-CC-2019-05/F00001/eng, f. 15.

si dhe efektivitetin e këtyre mjeteve të parapara me ligj; dhe (ii) faktin se çfarëdo zbatimi i ardhshëm i Urdhrit të ZPS-së do të bëhej përmes procesit juridik, duke kërkuar vendim nga Dhomat e Specializuara, siç sugjerohet në Urdhër.

17. Përveç kritereve të qarta të lartpërmendura për përdorimin e të gjitha mjeteve juridike të lartpërmendura, parimi i subsidiaritetit dhe interesi i administrimit të duhur të drejtësisë theksojnë fuqimisht që procesi i rregullt gjyqësor të lejohet të kalojë nëpër të gjitha hapat përkatëse.<sup>21</sup> Autoriteteve përkatëse gjyqësore, duke filluar me gjykatësin e procedurës paraprake ose gjykatësin e vetëm, duhet t'u jepet mundësia të ushtrojnë kompetencat e tyre të interpretimit në zhvillimin e të drejtave dhe mjeteve juridike ekzistuese në dispozicion të Parashtruesit si dhe të çdo parashtruesi tjetër në të ardhmen.<sup>22</sup>

18. Thjesht pohimi se nuk ekzistojnë mjetet juridike, sikurse bën Parashtruesi në Referimin e tij,<sup>23</sup> nuk përbën demonstrim *prima facie* të pranueshmërisë. Në mungesë të këtij demonstrimi, kërkesa për masa të përkohshme nuk duhet të miratohet, dhe Referimi duhet të hidhet poshtë menjëherë.<sup>24</sup>

## II. Nuk ka rrezik për dëm të rëndë dhe të pandreqshëm

<sup>21</sup> Shih, për shembull, GJKK, Rasti nr. KI 08/11, *Parashtrues të kërkesës Malush Sopa, Sedat Kuqi, Fazli Morina, Rahman Kabashi dhe Liman Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, 24 prill 2012, para. 46-49; GJKK, Rasti nr. KI 58/13, *Parashtrues i kërkesës z. Sadik Bislimi*, Aktvendim për Papranueshmëri, 25 nëntor 2013, para. 28-32 ('çdoherë kur pretendohet shkelja e të drejtave të njeriut, nuk është e thënë që ky pretendim të arrijë në Gjykatën Kushtetuese para se të shqyrtohet paraprakisht nga gjykatat e rregullta' (para. 31)); GJKK, Rasti nr. KI 17/13, *Parashtrues i kërkesës Bujar Bukoshi*, Vendim për Kërkesën për Masë të Përkohshme, 14 mars 2013, para. 27-28; GJKK, Rasti nr. KI 102/16, *Parashtrues i kërkesës Shefqet Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri, 2 mars 2017, para 41-43; GJKK, Rasti nr. KI 23/10, *Parashtrues i kërkesës Jovica Gadžić*, Aktvendim për Papranueshmëri, 19 shtator 2013, para. 47-49; GJKK, Rasti nr. KI 07/13, *Parashtrues i kërkesës Ibish Kastrati*, Aktvendim për Papranueshmëri, 5 korrik 2013, para. 25-29.

<sup>22</sup> Shih, për shembull, GJEDNJ, *Ciupercescu v. Romania*, nr. 35555/03, 15 qershor 2010, para. 169.

<sup>23</sup> Referim, KSC-CC-2019-05/F00001/eng, f.10, 14-15.

<sup>24</sup> Rregullorja e Punës, rregulla 14(d) (që parashikon hedhjen poshtë menjëherë të referimeve të dorëzuara jashtë afatit). Rregulla 20(a) e Rregullores së Punës përcakton afatet e zbatueshme për parashtrimin e kërkesave referuese nga individët dhe, siç tregohet më lart, kërkon që referimi të dorëzohet brenda dy muajsh nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar, pasi janë përdorur të gjitha mjetet juridike të efektshme që parashikon ligji.

19. Në kundërshtim me parashtrimet e Parashtruesit,<sup>25</sup> Parashtruesi nuk kërcënohet dhe nuk do të kërcënohet me masa kundër tij, nëse më 11 shkurt 2019 merr një vendim të lirë dhe të bazuar në informacion lidhur me shfrytëzimin e së drejtës së tij për të mos inkriminuar vetveten.<sup>26</sup> Në Referim, Parashtruesi qëllimisht i përzien gjuhën e përdorur në Fletëthirrje me atë të përdorur në Urdhër, për të argumentuar se po kërcënohet me burgim nëse do të shfrytëzojë të drejtën e tij për të mos inkriminuar veten. Kjo nuk është e vërtetë. Përkundrazi, çështja do t'i nënshtrohej procesit gjyqësor. Nëse palët nuk pajtohen në lidhje me fushëveprimin e së drejtës për të mos inkriminuar veten në kontekstin e dorëzimit të dokumenteve, ZPS-ja, siç sugjerohet në Urdhër, mund ta paraqesë çështjen para një gjykatësi të procedurës paraprake ose një gjykatësi të vetëm, për të kërkuar zbatimin e tij. Në atë rast, Parashtruesi do të kishte mundësinë të paraqiste argumentet e tij dhe për to të merrej vendim, dhe, nëse do të ishte e nevojshme e pasi të ishin përdorur të gjitha mjetet e tjera juridike efektive, të paraqiste pretendime për shkelje të të drejtave të tij para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Pra, nuk ka asnjë kërcënim për marrje masash në lidhje me shfrytëzimin e të drejtave të tij dhe asnjë detyrim në lidhje me Urdhrin nuk do të ndodhë pa mbikëqyrje gjyqësore.

20. Gjithashtu, në mënyrë që Parashtruesi të ketë mundësinë të marrë këshilla ligjore përkatëse në kohë, Urdhri e informon atë për statusin e tij dhe të drejtën e ndihmës nga një mbrojtës,<sup>27</sup> dhe në të njëjtën kohë i jep edhe të dhënat e kontaktit të Zyrës së Mbrojtjes brenda Zyrës Administrative. Vetë parashtrimi i Referimit tregon se Parashtruesi ka pasur mundësi ta ushtrojë në mënyrë efektive të drejtën e tij për mbrojtës, çka në vetvete përbën një garanci procedurale kyçe përkitazi së drejtës për

---

<sup>25</sup> Referim, KSC-CC-2019-05/F00001/eng, f.13, 19.

<sup>26</sup> Shih, për shembull, ECtHR, GC, *Ibrahim and Others v. The United Kingdom*, nr. 50541/08, 50571/08, 50573/08 dhe 40351/09, 13 shtator 2016, para. 267 (ku thuhet se e drejta e personit për të mos inkriminuar veten nuk është vetvetiu mbrojtje nga vetinkriminimi, por mbrojtje nga detyrimi i palejueshëm në marrjen e provave që i nënshtrohen mbrojtjes nga vetinkriminimi. Duhet të merret në shqyrtim lloji dhe shkalla e çfarëdo detyrimi).

<sup>27</sup> Rregullorja e DHSK-së, rregulla 43(3).



të mos inkriminuar vetveten.<sup>28</sup> Në paraqitjen e tij më 11 shkurt 2019, në kuadër të procedurës së rregullt, Parashtruesi do të informohet plotësisht për të drejtat e tij në përputhje me nenin 38(3) të Ligjit, përfshirë të drejtën për të heshtur dhe për të mos inkriminuar veten.

21. Përpos kësaj, masat e përkohshme nuk kërkohen për të trajtuar ndonjë dëm teorik në të ardhmen që mund të shkaktohej nëse me kalimin e kohës, ZPS-ja do të ngrinte aktakuzë kundër Parashtruesit dhe kërkon të përdorë dokumentet e përftuara në bazë të Urdhrit.<sup>29</sup> Ky skenar jo vetëm që është tejet hamendësues në këtë fazë, por përpara se të ndodhë kjo, duhet të kalohet nëpër shumë nivele të mbikëqyrjes gjyqësore. Për më tepër, edhe sikur në fund të dalin këto rrethana dhe të konstatohet se tentimi për t'i përdorur dokumentet në atë mënyrë përbën shkelje të së drejtës së Parashtruesit për të mos inkriminuar vetveten, çfarëdo dëmi i mundshëm mund të ndreqet me anë të një urdhri që përjashton përfshirjen e dokumenteve si prova.

22. Për rrjedhojë, nuk ka asnjë rrezik që Parashtruesit t'i shkaktohet dëm i rëndë nëse kërkesa për masa të përkohshme nuk miratohet dhe Referimi duhet të refuzohet.

### **Klasifikimi**

23. Kjo përgjigje parashtrohet për protokollim si dokument publik, në përputhje me Referimin dhe Njoftimin. ZPS-ja vëren se Referimi përmban disa të dhëna të kontaktit të Parashtruesit<sup>30</sup> të cilat, në interes të mbrojtjes së privatësisë dhe mirëqenies së Parashtruesit, do të ishte e përshtatshme të redaktohen nga versionet e publikuara të parashtrimit.

---

<sup>28</sup> Shih, për shembull, ECtHR, GC, *Salduz v. Turkey*, nr. 36391/02, 27 nëntor 2008, para. 54 ('qasja e hershme në një avokat është pjesë e garancive procedurale që Gjykata do t'i mbajë veçanërisht parasysht kur shqyrton nëse një procedurë ka shuar vetë thelbin e privilegjit të mbrojtjes nga inkriminimi i vetvetes').

<sup>29</sup> *Contra* Referim, KSC-CC-2019-05/F00001/eng, f. 21-24.

<sup>30</sup> Shih për shembull, Referim, KSC-CC-2019-05/F00001/eng, f. 5.

**Masa e kërkuar**

24. Për arsyet e lartpërmendura, Paneli duhet:
- a. ta refuzojë Kërkesën; dhe
  - b. ta deklarojë Referimin të papranueshëm *prima facie* ose ta ftojë ZPS-në të bëjë parashtrime për pranueshmërinë dhe themelësinë e tij.

/nënshkrim/

**Xhek Smith**

**Prokuror i Specializuar**

Hartuar në anglishte, më 25 janar 2019  
Në Hagë, Holandë